



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE PROCEDURALE LIGJORE DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË

Nr. 693 Prot

Tiranë, me 11.11.2013

Lënda: Dërgohet rekomandim për nxitjen e programeve të punësimit për grupet vulnerabël

Drejtuar **Z. Viktor TUSHAJ**
KRYETAR
BASHKIA LEZHË

LEZHË

I Nderuar Kryetar!

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përparrë ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin si dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të nenit 32, pika 1, shkronja “f”, të këtij ligji, për të bërë rekomandime përfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Në kuadër të projektit me titull “*Për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të personave të diskriminuar*”, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) në partneritet me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, mbështetur financiarisht nga Zyra e Kooperacionit Zviceran në Tiranë, po zhvillohen Ditë të Hapura dhe takime me OFJ-të në qytete të ndryshme të Shqipërisë, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për Ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi” dhe zbatimin e tij të plotë nga gjithë aktorët e përcaktuar në ligj.

Në Ditët e Hapura, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe KShH kanë konstatuar si një ndër problematikat më të rëndësishme mungesën e punësimit për grupet vulnerabël, veçanërisht për komunitetin rom dhe egjiptian si dhe personat me aftësi të kufizuara.

Përsa i përket punësimit të komunitetit rom dhe egjiptian, mund t’i referohemi “Dekadës së Përfshirjes së Romëve”, një dokument i cili synon integrimin e minoritetit Rom në Shqipëri

në jetën social-ekonomike, ku punësimi është një nga priorititetet globale dhe Planit Kombëtar të Veprimit 2010-2015, i cili fokusohet në katër fusha kryesore, një nga të cilat është punësimi. Një nga qëllimet strategjike të Dekadës Rome parashikon fuqizimin e komunitetit Rom përmes rritjes së aksesit në tregun e punës, programeve të trajnimit dhe skemave të mbrojtjes sociale. Një nga pikat nëpërmjet të cilave parashikohet të arrihet ky objektiv është inicimi dhe zbatimi i programeve të veçanta që mundësojnë punësimin e Romëve, kryesisht nëpërmjet kryerjes së një studimi mbi situatën dhe shkaqet e papunësisë tek Romët; organizimit të fushatave informuese mbi mundësitë dhe përfitimet nga programet e punësimit; *përfshirjes më e madhe e Romëve në skemat për nxitjen e punësimit të individëve në nevojë, si skemat subvencionuese të pagës dhe kreditimi i taksave për punëdhënësit* dhe integrimi i komunitetit Rom në edukimin e përgjithshëm publik dhe trajnimin profesional kryesisht nëpërmjet hapjes së programeve të formimit profesional dhe programeve të tjera kualifikuese për të rinjtë Rom; ofrimit të kurseve të formimit profesional për të rinjtë Rom në punë tradicionale artizanale; përmirësimit të cilësisë së programeve të trajnimit profesional apo organizimit të fushatave informuese mbi të drejtat dhe detyrimet e Romëve në fushën e punësimit, programeve të ndihmës, dhe skemës së sigurimeve shoqërore.

Plani Vendor i Veprimit i Bashkisë Lezhë për Integrin e Romëve dhe Egjiptianëve 2013-2015, është një dokument i rëndësishëm i kësaj njësie vendore i cili synon integrimin e komuniteteve rom dhe egjiptian në jetën social-ekonomike. Një nga fushat në të cilat bazohet ky plan është punësimi dhe mbrojtja sociale, duke theksuar në këtë mënyrë priorititetet e "Dekadës së Përfshirjes Rome". Në fushën e punësimit, qëllimi i këtij plani vendor konsiston në përmirësimin e qëndrueshëm të situatës ekonomike të familjeve të komuniteteve rom dhe egjiptian nëpërmjet rritjes së mundësive për punësim, janë parashikuar edhe aktivitete konkrete për t'u ndërmarrë në përputhje me objektiva specifik, të cilat janë: nisja dhe zbatimi i programeve të veçanta që mundësojnë punësimin e romëve dhe egjiptianëve; integrimi i tyre në edukimin e përgjithshëm publik dhe trajtimin profesional; rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë; rritja e përftimeve nga skema e mbrojtjes sociale me anë të ndërmarrjes së masave lehtësuese dhe eliminimi i rasteve abuzive të shkeljes së legjislacionit të punës. Nga evidentimet e bëra në këtë Plan Veprimi, rezulton se romët dhe egjiptianët karakterizohen nga një nivel i lartë papunësie duke renditur si shkaqe: - mungesën e mundësive të punësimit për të gjithë në qytetin e Lezhës - nivelin e ulët arsimor - etnicitetin. Në këto kushte, rekomandimet që sugjerohen për politikat që lidhen me punësimin e anëtarëve të komuniteteve rom dhe egjiptian, janë: trajnimi profesional për anëtarët e këtyre komuniteteve në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe nevojat e secilit prej tyre; krijimi i bizneseve sociale, të cilët mund të kishin si partner, krahas pjesëtarëve të komuniteteve rom dhe egjiptian, edhe bashkinë/komunën dhe një institucion bankar; skema kreditimi për pjesëtarët e komuniteteve rom dhe egjiptian, që kanë krijuar një biznes të vogël ose janë të vetëpunësuar.

Nga sa më lart, në zbatim të këtij Plani Veprimi, Bashkia e Lezhës duhet të marrë masa konkrete për periudhën 2013-2015 me qëllim uljen e shkallës së papunësisë për anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, ofrimin e mundësive të barabarta në tregun e punës por edhe marrjen e veprimeve pozitive të cilat synojnë nxitjen e programeve të punësimit për këto kategorit.

Nga ana tjetër, lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, citojmë se në Ligjin Nr. 7995 datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit” (ndryshuar me ligjin nr. 8444, datë 21.01.1999, me ligjin nr. 8862 datë 7.03.2002 dhe me ligjin 9570 date 3.7.2006), thuhet shprehimisht se “çdo punëdhënës qe punëson me tepër se 24 punonjës, është i detyruar te punësojë një person me aftësi te kufizuar për çdo 25 punonjës te personelit te tij”.

Marrja e masave për nxitjen e programeve të punësimit është një funksion i organeve të qeverisjes vendore i përcaktuar në nenin 10, pika 3 të Ligjit Nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, ku parashikohet shprehimisht se komunat dhe bashkitë ushtrojnë funksionet e veta në kuadër të zhvillimit ekonomik vendor nëpërmjet përgatitjes së programeve të zhvillimit ekonomik vendor dhe zhvillimit të biznesit. Në këtë kuadër edhe nëse nuk ka kuota specifike vendore, si ato të përcaktuara më lart me një Plan konkret Veprimi për komunitetin rom dhe egjiptian, Bashkia e Lezhës duhet të nxise punësimin e personave me aftësi të kufizuar në zbatim të kuadrit ligjor ekzistues.


Sa më lart, në mbështetje të nenit 1 të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, që parashikohen shkaqet e diskriminimit dhe nga ku komuniteti rom/egjiptian dhe personat me aftësi të kufizuara hyjnë në objektin e këtij ligji dhe nenit 11 të këtij ligji që parashikon marrjen e masave të përkohshme dhe të veçantë që synojnë përshtypjen e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi, konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim, si dhe me qëllim garantimin e barazisë dhe mosdiskriminimit:

R E K O M A N D O J M E:

1. Bashkia Lezhë të ketë përparësi nxitjen e punësimit të komunitetit Rom dhe Egjiptian dhe Personave me Aftësi të Kufizuara, në respektim të kuadrit ligjor dhe rregullator ekzistues.
2. Bashkia Lezhë të ndërmjetësojë me bizneset private të kontraktuara nga vetë Bashkia, por sipas rastit edhe me bizneset e tjera me qëllim nxitjen e punësimit të grupeve vulnerabël. Një mënyrë konkrete e nxitjes së përfshirjes së Romëve/Egjiptianëve në punësim pranë bizneseve të kontraktuara nga Bashkia, është marrja e masave pozitive përmes vendosjes së kuotave për punësimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian në momentin e lidhjes së kontratave me këto biznese.

3. Marrjen e veprimeve pozitive të cilat synojnë nxitjen e punësimit për grupet vulnerabël.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al